

Lidhja e zonave të largëta të Shqipërisë me Programin e shkollës dixhitale



PROJEKTIT PËR CILËSINË DHE BARAZINË NË ARSIM

Lidhja e zonave të largëta të Shqipërisë me Programin e shkollës dixhitale

VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM

Lëvizja e lirë dhe përpjekjet për një jetë më të mirë afër zonave urbane në fillim të viteve '90 shkaktuan migrim intensiv të dhjetëra mijë familjeve që lëvizën nga banesat dhe zonat e tyre të origjinës brenda për brenda Shqipërisë. Si rezultat, cilësia e arsimit, nga një rrjet të dikurshëm me shkolla të mirëorganizuar në ato zona, u përkeqësua dhe ndjekja e shkollës ra.

SFIDA

Arsimi njihet në mënyrë universale si kyçi për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të lehtësuar varfërinë, si në nivel lokal dhe në atë kombëtar. Ekonomia shqiptare gjithnjë e më shumë ka nevojë për një krah pune më të sofistikuar të pajisur me aftësitë njohurite e përshtatshme të vendit të punës, të cilat nuk mund të zhvillohen vetëm nëpërmjet një arsimit bazë. Megjithëse cilësia e arsimit dhe rezultatet e nxënësve janë në rritje në Shqipëri, progresi për komunitetet rurale nuk është aq i shpejtë sa në ato urbane. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe rezultateve të provimeve të Maturës, fëmijët në zonat rurale regjistrohen më pak në arsimin e mesëm dhe kanë rezultate më të ulëta krahasuar me ata në zonat urbane.

Si një strategji për përmirësimin e rezultateve të arsimit, ndërkohë që reduktohet hendeku ndërmjet zonave urbane dhe rurale, Qeveria shqiptare ka futur programin e shkollës dixhitale me mbështetjen e Bankës Botërore dhe donatorëve e tjerë. Ky program kërkon të promovojë cilësinë e arsimit për të gjithë studentët, ndërkohë që pakëson dallimet e shumta që ekzistojnë ndërmjet shkollave urbane dhe rurale. Në zonat rurale, një problem i veçantë i shënjestruar në kuadër të projektit, janë ndërtesat përgjithësisht të degraduara të shkollave, përfshirë mungesën e laboratorëve dhe materialet e pamjaftueshme didaktike të mësimdhënies.

Në kuadër të programit të shkollës dixhitale, është futur në shkolla një program i ri mbi teknologjinë e kompjuterit, u blenë dhe dorëzuan laboratorë të rinj kompjuteri në shkollat e mbarë Shqipërisë, shkollat tani kanë akses në internet, dhe

MULTIMEDIA

Loading the player ...

More Results



16,819

më shumë kompjuterë u blenë për shkollat 9-vjecare dhe të mesme, duke dyfishuar numrin e kompjuterëve të disponueshëm për nxënësit shqiptarë.

Në vitin 2009, një kompjuter ishte i disponueshëm për 25 nxënës, ndërkohë që në vitin 2006 kishte mesatarisht 61 nxënës për kompjuter, ndërkohë që në zonat rurale vetëm 148 nxënës për kompjuter.

mësuesit u trajnuan mbi mësimdhënien e aftësive kompjuterike për shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme përse i përket mbylljes së hendekut dixhital – sipas UNICEF në vitin 2006 vetëm 20 përqind e fëmijëve ruralë dinin si të përdornin kompjuterët, krahasuar me 50 përqind të fëmijëve urbanë.

Më shumë se 520,000 nxënës po përfitojnë nga Projekti, i cili është zbatuar në 250 shkolla fillore, 1,477 shkolla 9-vjeçare dhe 380 shkolla të mesme.

QASJA

Njerëzit e përdorin teknologjinë e komunikimit si një mënyrë efektive për të takuar njerëz të rinj, për të kërkuar dhe punuar në një shoqëri të globalizuar. Futja e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në shkolla nëpërmjet Programit të Shkollës Dixhitale u zgjodh si një strategji për të përmirësuar arsimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, përfshirë dhe lidhjen e atyre që jetojnë në zonat e largëta me bashkëmoshatarët e tyre në zonat urbane dhe pjesën tjetër të botës. Në kuadër të programit, shkollat marrin një laborator kompjuteri me lidhje në internet dhe mësuesit trajnohen mbi përdorimin e mjeteve interaktive me kurrikulën e tyre. Banka Botërore po e mbështet këtë program në kuadër të "Projektit për Cilësinë dhe Barazinë në Arsim", përmes një kredie në shumën 15 milionë USD (Projekti EEE).

MË SHUMË INFORMACION (NË ANGLISHT)

» Projektit për Cilësinë dhe Barazinë në Arsim

MATERIALE

» Slide-Show

REZULTATET

Objekti i komponentit të shkollës dixhitale të Projektit EEE është të fusë aftësitë rreth TIK për të gjithë nxënësit shqiptarë në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm. Në veçanti, komponenti mbështet:

- Zhvillimin dhe zbatimin e një kuadri kombëtar të kurrikulës së TIK dhe tekste shkollore mbi kompjuterin për nivelin e shkollës 9-vjeçare dhe të mesme;
- Pajisjen e të gjithë shkollave me laboratorë kompjuteri dhe lidhje interneti dhe mjete të tjera të TIK siç janë laptop, projektorë dhe burime dixhitale.
- Trajnimi i mësuesve në kuadër të Programit të shkollave elektronike. Aktualisht, më shumë se 1,380 mësues të arsimit 9-vjeçar dhe rreth 400 mësues të arsimit të mesëm kanë marrë trajnim mbi informatikën. Në vitin e ardhshëm, projekti do të mbështesë trajnimin e një grupi shtesë të mësuesve mbi përfshirjen e teknologjisë në metodologjitë e mësimdhënies.

“Duke ndihmuar në ngushtimin e ndarjes dixhitale në Shqipëri, ky projekt po ndihmon fëmijët shqiptarë të mësojnë programet e kompjuterit, të lundrojnë në internet dhe të ndajnë dhe luajnë me fëmijët e tjerë nga e gjithë bota. Por, më e rëndësishmja është se ky projekt i përgatit ata për të konkurruar në tregun e nesërm global të punës. Ky projekt do të ndihmojë dhe mësuesit për t’u afruar me nxënësit duke u dhënë atyre mundësi që të mësojnë vetë ato që ata nuk kishin mësuar kur ishin nxënës.”

—nga Drejtuesja e Projektit, Gentjana Sula

“Unë mund të them se ishte e paimagjinueshme të përdorëshin fotografi ose të dhëna nga interneti si informacion bazë në klasat

e gjeografisë. Për disa vite, klasat e mësimdhënies ishin rutinë çdo vit, kështu që i njëjti informacion u transmetohej nxënësve nga viti në vit – çdo gjë ishte e kufizuar dhe e lidhur me të njëjtin libër dhe me të njëjtin tekst. Por tani, klasat e gjeografisë, gjatë të cilave p.sh. shpjegohet Japonia, mund të lidhet me një llojshmëri informacioni të shkarkuar nga laboratorit i informatikës. Janë nxënësit që e kërkojnë, duke filluar nga fotot e thjeshta deri tek informacioni më i ndërlikuar, si p.sh. ndryshimi i strukturave gjeografike dhe madje informacionin më të fundit dhe më të përditësuar. ”

— *Sipas Klementina Ferhatit, mësuese e gjeografisë dhe kompjuterit në klasën e 9-të të shkollës në Fushas, Baldushk,*

E ARDHMJA

Performanca e sektorit të arsimit do të ishte një përcaktues kryesor i konkurrueshmërisë dhe rritjes ekonomike të Shqipërisë në të ardhmen. Duke marrë parasysh aspiratat e Shqipërisë për të ruajtur rritjen, ngushtuar pabarazitë rajonale dhe për t'u bashkuar me BE, sfida kryesore në sektorin e arsimit është zhvillimi i një sistemi dhe institucioneve që do të përgatisin të diplomuarit nga shkollat për të funksionuar me efikasitet në tregjet e punës. Banka Botërore ka dhënë 36.6 milionë USD nëpërmjet tre projekteve për të përmirësuar sistemin arsimor në Shqipëri.